



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.86**

**2005**

**14 nëntor**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9433 datë 20.10.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për huanë dhënë shoqërisë “Tirana Airport Partners (TAP)” sh.p.k. nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Punët e infrastrukturës publike dhe ndërtimi i seksionit rrugor të aeroportit”.....	2787
Ligj nr.9434 datë 20.10.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Sllovaqe për ristrukturimin dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Sllovaqe”.....	2789
Ligj nr.9435 datë 20.10.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për shtesa dhe ndryshime në kontratën financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rrugëve europiane-Shqipëria”.....	2793
Ligj nr.9436 datë 20.10.2005	Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2004.....	2802

**L I G J**  
**Nr. 9433, datë 20.10.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR HUANË DHËNË SHOQËRISË “TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP)” SHPK NGA BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN “PUNËT E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE NDËRTIMI I SEKSIONIT RRUGOR TË AEROPORTIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për huanë dhënë shoqërisë “Tirana Airport Partners (TAP)” shpk nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin “Punët e infrastrukturës publike dhe ndërtimi i seksionit rrugor të aeroportit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4690, datë 8.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE GARANCIE**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE**  
**PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE TË INFRASTRUKTURËS**  
**PUBLIKE DHE SEKSIONIT RRUGOR TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA”**

Marrëveshje e datës 23 mars 2005 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Garantuesi”) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”)

Hyrje

Meqenëse në bazë të Marrëveshjes së huasë të datës 23 mars 2005 ndërmjet Tirana Airport Partners sh.p.k. si Huamarrës dhe Bankës (Marrëveshja e huasë sipas parashikimit të termave dhe kushteve standarde), Banka ka rënë dakord t’i japë Huamarrësit një hua në shumën 9 000 000 euro, në përputhje me termat dhe kushtet e caktuara në marrëveshjen e huasë dhe pagimin e një takse të Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore (një kusht i tillë parashikohet në marrëveshjen e koncesionit) nga Huamarrësi të Garantuesi, por me kusht që Garantuesi të garantojë përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë, në përputhje dhe me këtë Marrëveshje;

*meqenëse* Garantuesi dhe Huamarrësi kanë kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e pjesës së projektit në përputhje me sesionin 2.03 të Marrëveshjes së huasë;  
*meqenëse* Garantuesi, duke vlerësuar lidhjen e Marrëveshjes së huasë nga Banka me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë përmbushjen e detyrimeve të tilla për Huamarrësin; për sa më sipër, palët bien dakord si vijon:

#### Neni 1

### **Termat dhe kushtet standarde, përkufizimet**

Seksioni 1.01 Fusha e zbatimit të termave dhe kushteve standarde

Të gjitha dispozitat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të shkurtit 1999 kanë efekt dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të gjithë fuqinë dhe efektin e tyre, njëllëj si të ishin parashikuar në këtë Marrëveshje, por me ndryshimet që vijnë (dispozita të tilla të ndryshuara janë quajtur në vijim “Termat dhe kushtet standarde”);

a) Seksioni 4.03 (“Prokurimi”) i termave dhe kushteve standarde të Bankës të shkurtit 1999 nuk është i zbatueshëm për këtë Marrëveshje.

Seksioni 1.02 Përkufizime

Kudo që të jetë përdorur në këtë Marrëveshje (përfshirë pjesën e hyrjes), përderisa nuk është thënë ndryshe ose konteksti të ketë kërkesa të tjera, kushtet e parashikuara në hyrje kanë kuptimin që u jepet në këtë Marrëveshje, kushtet e parashikuara në emrat dhe kushtet standarde dhe në marrëveshjen e huasë kanë kuptimet e dhëna në to dhe përkufizimi “Përfaqësuesi i autorizuar i garantuesit” është Ministri i Financave i Garantuesit.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë marrëveshje, referenca për një nen ose seksion, me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, do të konsiderohet si referencë për këtë nen ose seksion të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 2

### **Garancia, detyrime të tjera**

Seksioni 2.01 Garancia shtetërore

Garantuesi këtu garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari kryesor dhe jo thjesht si garant, pagimin e përpiktë të çdo dhe të gjitha shumave sipas Marrëveshjes së huasë, qoftë në momentin e maturimit, me parapagim ose ndryshe, si edhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, ashtu siç janë parashtruar në Marrëveshjen e huasë.

Seksioni 2.02 Taksa e Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore

Palët bien dakord që Garantuesi ka të drejtë të kërkojë pagesën e Taksës së Garancisë së Transhit të Huasë Shtetërore nga Huamarrësi në përputhje me klauzolën 20(d) dhe shtojcën 69 të marrëveshjes së koncesionit.

#### Neni 3

### **Të ndryshme**

Seksioni 3.01 Njoftime

Adresat e mëposhtme parashikohen në funksion të seksionit 10.01 të termave dhe kushteve standarde:

Për Garantuesin:  
Ministria e Financave e Republikës së  
Shqipërisë  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”  
Nr.1 Tiranë, Shqipëri  
Në vëmendje të: Drejtorit të Drejtorisë së  
Borxhit  
Fax: +355 4 228494

Për Bankën:  
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
One Exchange Square  
London EC2A 2 JN, UK  
To the attention of: Operational Administration  
Unit  
Fax: +44 20 7338 6100  
Telex: 8812161  
Answerback: EBRD L G

#### Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Në funksion të seksionit 9.03 (b) të termave dhe kushteve standarde dhe në përputhje me seksionin 5.02 (b) të Marrëveshjes së huasë, opinioni apo opinionet ligjore në emër të Garantuesit do të jepen nga Ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të sa më sipër, palët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruan këtë Marrëveshje në katër kopje, në Tiranë, Shqipëri, në ditën dhe vitin e përcaktuar më lart.

Republika e Shqipërisë Banka Europiane për  
Rindërtim dhe Zhvillim  
Nga: Arben Malaj  
Pozicioni: Ministër i Financave

Nga: Riccardo Puliti  
Pozicioni: Drejtor

### L I G J

Nr. 9434, datë 20.10.2005

## **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SLLOVAKE PËR RISTRUKTURIMIN DHE SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS SLLOVAKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### V E N D O S I:

#### Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Sllovaqe për ristrukturimin dhe shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Sllovaqe”.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4691, datë 8.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

## MARRËVESHJE

### NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SLOVAKE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI RISTRUKTURIMIN DHE SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS SLOVAKE

Qeveria e Republikës Sllovaqe dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë “Palët Kontraktuese”),

*duke pasur parasysh* rëndësinë e shlyerjes së detyrimeve ndërmjet ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe dhe Republikës së Shqipërisë në favor të ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe, sipas protokollit ndërmjet Qeverisë të Republikës Federale Çeke e Sllovaqe dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi zgjidhjen e të ardhurave dhe detyrimeve reciproke në kuadrin e marrëdhënieve ekzistuese të pagesave deri më 31.12.1991, nënshkruar në Tiranë më 23 janar 1992;

*duke marrë parasysh* notën nr.584/94-NO të datës 4 tetor 1994 të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Sllovaqe drejtuar Ambasadës së Republikës të Shqipërisë në Pragë mbi ndarjen ndërmjet Republikës Sllovaqe dhe Republikës Çeke të të ardhurave dhe detyrimeve të ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe kundrejt vendeve të treta;

*duke respektuar* faktin që Republika Sllovaqe si një nga dy pasardhësit e ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe, administron vetë në mënyrë të pavarur pjesën e saj të të ardhurave dhe detyrimeve të ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe kundrejt vendeve të treta;

*duke pasur parasysh* konkluzionet e protokollit të bisedimeve ndërmjet përfaqësuesve të Komitetit Qeveritar të Bisedimit të Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë, Ministrisë së Financave të Republikës Çeke, Ministrisë së Financave të Republikës Sllovaqe, Cekoslovenska Obchodna Banka, a.s. dhe Narodna Banka Slovenska, të datës 8 shtator 2004;

*me dëshirën* për të zgjeruar bashkëpunimin tregtaro-ekonomik, tekniko-shkencor dhe kulturor që ka ekzistuar në të shkuarën ndërmjet Republikës Sllovaqe dhe Republikës së Shqipërisë, me qëllim forcimin e lidhjeve miqësore dhe të mirëkuptimit ndërmjet dy kombeve,

kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

1.1 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe, i miratuar në protokollin e bisedimeve ndërmjet përfaqësuesve të Komitetit Qeveritar të Bisedimit të Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë, Ministrisë së Financave të Republikës Çeke, Ministrisë së Financave të Republikës Sllovaqe, Cekoslovenska Obchodna Banka, a.s. dhe Narodna Banka Slovenska, të datës 8 shtator 2004 përbëhet nga:

a) principlali në rubla klering (më poshtë clg. RBL) në shumën 471 348.99 clg. RBL, nga e cila pjesa e Republikës Sllovaqe është 147 116.33 clg. RBL;

b) shuma e shprehur në dollarë klering (më pas “clg. USD”) e përbërë nga principlali prej 15 039 622.15 clg. USD dhe interesi prej 3 023 186.45 clg. USD, nga të cilat pjesa e Republikës Sllovaqe është 5 013 207.38 clg. USD principlal dhe 1 007 728.82 clg. USD interes.

1.2 Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt ish-Republikës Federale Çeke e Sllovaqe, i përcaktuar në paragrafin 1.1 të këtij neni, do të rritet duke përdorur normën origjinale të interesit, me interesin e llogaritur deri më 31.12.2004, për shumën prej 286 256.17 clg. USD, nga e cila pjesa e Republikës Sllovaqe është 95 418.72 clg. USD.

#### Neni 2

2.1 Pjesa e Republikës Sllovaqe në borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt ish-Republikës Federate Çeke e Sllovaqe në clg. RBL dhe clg. USD do të konvertohet në dollarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (më pas “USD”) duke përdorur kursin e këmbimit 3.3 clg. RBL=1 USD dhe 1 clg. USD = 1 USD.

Në përputhje me tepricat e detyrimit të theksuara në nenin 1 dhe me kurset e lartpërmendura të këmbimit, borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Sllovaqe sipas gjendjes më 31.12.2004 arrin shumën 6 163 965.93 USD.

2.2 Shuma e interesit prej 1 103 147.54 USD sipas gjendjes më 31.12.2004 dhe interesi i llogaritur nga 1 janari 2005 deri në datën e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje, do të falen.

Borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës Sllovaqe sipas gjendjes më 31.12.2004 (më pas i quajtur “Borxhi”) është 5 060 818.39 USD.

### Neni 3

3.1 Borxhi në shumën prej 5 060 818.39 USD do të paguhet në dhjetë këste të barabarta vjetore në përputhje me përcaktimet e lidhjes 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Këstet do të paguhen më 1 nëntor të çdo viti. Kësti i parë do të paguhet më 1 nëntor 2005.

3.3 Mbi tepricën e papaguar të borxhit do të llogaritet interes në masën 1.75% në vit (një vit do të konsiderohet i barabartë 360/360 ditë). Llogaritja e interesit do të fillojë nga data e bërjes efektive të kësaj Marrëveshjeje. Periudha e parë e llogaritjes së interesit është nga data e bërjes efektive të Marrëveshjes deri më 31 tetor 2005, përfshirë. Periudhat e mëpasshme të llogaritjes së interesit janë nga 1 nëntori i çdo viti deri më 1 tetor të vitit pasues.

3.4 Për çdo vit, interesat nga teprica e papaguar e borxhit të llogaritur sipas paragrafit 3.3 të këtij neni do të paguhen në përputhje me lidhjen 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3.5 Pala shqiptare, me mjetet e Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, do të kryejë çdo pagesë të principalit sipas paragrafëve 3.1. dhe 3.2. të këtij neni dhe çdo pagesë të interesit të llogaritur mbi tepricën e papaguar të borxhit sipas paragrafëve 3.3. dhe 3.4. të këtij neni (më pas referuar si “këstet”) pa mbajtur komisione bankare apo pa bërë zbritje të tjera, në favor të Ministrisë së Financave të Republikës Sllovaqe, në llogarinë e Narodna Banka Slovenska me Citibank N.A., New York, Swift code: CITIU S33, Nr.36017699, duke njoftuar më parë për pagesën Narodna Banka Slovenska.

3.6 Data e pagesës është data e xhimit të kësteve në llogarinë e lartpërmendur me Narodna Banka Slovenska. Në rastet kur në datën e pagesës bankat në Republikën Sllovaqe, në Republikën e Shqipërisë ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë pushim, pagesa do të bëhet në ditën pasuese të punës. Brenda 15 ditëve nga marrja e çdo kësti, Narodna Banka Slovenska do t'i dërgojë një njoftim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë.

3.7 Në rast se ndonjë pagesë e principalit nuk do të kryhet në shumën e duhur në datën e maturimit, Palët Kontraktuese bien dakord për aplikimin e interesvonesave në masën 4.25% në vit (një vit do të konsiderohet i barabartë 360/360 ditë), i cili do të llogaritet nga dita pasuese e datës së maturimit të këtij kësti të principalit deri në ditën e pagesës së tij.

3.8 Interesvonesat sipas paragrafit 3.7 të këtij neni, duhen paguar brenda 30 ditëve kalendarike nga data e planifikuar e pagesës së të gjithë këstit të papaguar ose të një pjese të papaguar të tij.

### Neni 4

4.1 Ministria e Financave e Republikës Sllovaqe dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë përgjigjen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

4.2 Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese mund t' i drejtohen njëra-tjetrës në këto adresa:

Ministerstvo financii Slovenskej republiky  
Attn: Sekcia štátneho výkazníctva  
Štefanovicova c. 5, P.O. BOX 82  
817 82 Bratislava 15, Slovenská republika  
Fax: ++ (421 2) 59583216

Ministry of Finance of Albania  
Attn: Debt Department  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.1  
Tirana, Albania  
Fax: ++ (355 4) 228494  
++ (355 4) 258435

Národna Banka Slovenska  
Attn: Department 07  
I Karvaša 1,813 25 Bratislava  
Slovenská Republika  
Fax: ++ (421 2) 57871148

4.3 Ministria e Financave e Republikës Sllovaqe autorizon Narodna Banka Slovenska për administrimin teknik dhe bankar të kësaj Marrëveshjeje.

4.4. Në rast të ndonjë ndryshimi lidhur me realizimin teknik dhe bankar të kësaj Marrëveshjeje, i cili nuk prek kushtet e ripagesës së borxhit të rënë dakord në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, Ministria e Financave e Republikës Sllovaqe autorizon Narodna Banka Slovenska të kryejë këto ndryshime në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

5.1 Palët Kontraktuese do të njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën në rrugë diplomatike mbi përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën më të fundit të këtyre njoftimeve.

5.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë vlefshmëria e protokollit të nëshkruar më 23 janar 1992 në Tiranë ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale Çeke e Sllovaqe dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi rregullimin e të ardhurave dhe detyrimeve dypalëshe në kuadrin e marrëdhënieve të pagesave sipas gjendjes më 31 dhjetor 1991.

5.3 Marrëveshja është e vlefshme deri në pagesën e të gjitha kësteve, si edhe të interesvonesave të mundshme.

5.4 Marrëveshja mund të ndryshohet apo plotësohet mbi bazën e një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet e Marrëveshjes duhet të jenë në formë të shkruar.

5.5 Në qoftë se gjatë zbatimit të Marrëveshjes do të ketë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese lidhur me zbatimin e saj, këto mosmarrëveshje do të zgjidhen në rrugë diplomatike me konsultime dypalëshe ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Financave të Republikës Sllovaqe të autorizuar nga Ministri i Financave i Republikës Sllovaqe dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të autorizuar nga Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë.

Në vërtetim të sa më sipër, personat e autorizuar ligjërisht kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në..... më.....2005 në dy origjinale në gjuhën angleze.

LIDHJA 1

Data e pagesës	Principali	Interesi
1 nëntor 2005	506 081.84 USD	Në përputhje me nenin 3 paragrafi 3.3
1 nëntor 2006	506 081.84 USD	79 707.88 USD
1 nëntor 2007	506 081.84 USD	70 851.46 USD
1 nëntor 2008	506 081.84 USD	61 995.03 USD
1 nëntor 2009	506 081.84 USD	53 138.59 USD
1 nëntor 2010	506 081.84 USD	44 282.16 USD
1 nëntor 2011	506 081.84 USD	35 425.73 USD
1 nëntor 2012	506 081.84 USD	26 569.30 USD
1 nëntor 2013	506 081.84 USD	17 712.86 USD
1 nëntor 2014	506 081.84 USD	8 856.43 USD
Gjithsej	5 060 818.39 USD	398 539.45 USD + interesin që duhet paguar më 1 nëntor 2005

**L I G J**

**Nr. 9435, datë 20.10.2005**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR SHTESA DHE NDRYSHIME NË  
KONTRATËN FINANCIARE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS  
EUROPIANE TË INVESTIMEVE PËR PROJEKTIN E RRUGËVE EUROPIANE –  
SHQIPËRIA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja për shtesa dhe ndryshime në kontratën financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve për projektin e rrugëve europiane – Shqipëria”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4689, datë 1.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJA**  
**PËR SHTOJCA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN FINANCIARE MIDIS REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE**

Kjo Marrëveshje është midis:

Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Financave, z.Ridvan Bode, që gjithashtu vepron në emër të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, e quajtur “Huamarrësi”, nga njëra anë, dhe Bankës Europiane të Investimeve me seli në Luksemburg, përfaqësuar nga Znj.Grammatiki Tsingou Papadopetrou, drejtor dhe z. Matteo Rivellini, këshilltar ligjor, që këtu e tutje quhet “Banka”.

Pala tjetër, ku:

- nëpërmjet një kontrate financiare (këtej e tutje e quajtur “Kontrata Financiare”), e datës 8 dhjetor 2000, midis Huamarrësit dhe Bankës, Banka ka vendosur në favor të Huamarrësit një kredi të barasvlefshme me 34 000 000 euro (tridhjetë e katër milionë), për të vetmin qëllim, të financojë pjesë të Projektit, të përcaktuar qysh në fillim;

- Projekti, siç ishte përcaktuar fillimisht, përbëhet nga dy seksione rrugore: i) rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugës Lushnjë-Fier-Vlorë (62 km); dhe ii) rehabilitimi dhe përmirësimi i rrugës Tepelenë-Gjirokastër (24 km);

- gjatë përgatitjeve për seksionin rrugor të përmendur te pika “i”, projekti i nënseksionit Fier-Vlorë ishte ndryshuar nga përmirësimi fillestar i rrugës ekzistuese në ndërtimin e një rruge të re në një gjurmë tjetër dhe gjatësia e rrugës është ndryshuar nga 34 km në 41 km;

- fizibiliteti ekonomik i ndryshimit të mësipërm të Projektit nuk është bërë dhe, për shkak të zgjedhjes së gjurmëve të reja, do të nevojitej një studim i plotë mbi vlerësimin e ndikimit në ambient, që do të bënte që zbatimi i Projektit të jetë jashtë afateve kohore të përcaktuara në Kontratën Financiare;

- për shkak të ndryshimeve në Projekt, kostoja paraprake për ndërtimin e rrugës Fier-Vlorë është rishikuar nga vlera fillestare e parashikuar rreth 22 000 000 euro (njëzet e dy milionë) në 57 000 000 euro (pesëdhjetë e shtatë milionë), që bën që kostoja totale e Projektit të kalojë planin financiar të Kontratës Financiare me një masë të madhe;

- për shkak të ndryshimeve në Projekt që kanë lidhje me seksionin rrugor të përmendur te pika “ii”, kostoja e parashikuar e këtij seksioni është rishikuar duke pësuar një rritje nga 25 700 000 euro (njëzet e pesë milionë e shtatëqind mijë) e parashikuar fillimisht në 28 500 000 euro (njëzet e tetë milionë e pesëqind mijë);

- konsultimet e mëposhtme janë realizuar midis Bankës dhe Huamarrësit dhe nga puna rivlerësuese, vlera e Projektit do të zvogëlohet që të përfshijë vetëm nënseksionin Lushnjë-Fier për t’u bashkëfinancuar nga kooperacioni italian, së bashku me seksionin e përmendur te “ii” që do të bashkëfinancohet me Komisionin European (projekti i ri, sipas shtojcave, që më poshtë do të quhet “Projekti”);

- kostoja totale e rishikuar për Projektin, e parashikuar nga Banka, është 26 000 000 euro (njëzet e gjashtë milionë) për seksionin (i) të ndryshuar, të përmenduar më lart dhe 28 500 000 euro (njëzet e tetë milionë e pesëqind mijë) për seksionin (ii), të ndryshuar, të përmendur më lart, që mendohet të financohet si më poshtë vijon:

<b>Burimet financiare</b>	<b>Milionë euro</b>
Fonde nga vetë Huamarrësi	3.5
Kreditit (siç është përcaktuar më lart) nga Banka	19.0
Programi i BE-së “PHARE”	7.0
Kooperacioni Italian	25.0
Totali	54.5

- Për rrjedhojë, Banka ka për qëllim të zvogëlojë vlerën e kredisë nga 34 000 000 euro (tridhjetë e katër milionë) në 19 000 000 euro (nëntëmbëdhjetë milionë);

- Banka, duke pasur parasysh çështjet e përmendura më lart dhe në mënyrë që të mundësohet financimi i Projektit, ka vendosur të bëjë shtesa në disa masa të parashikuara në pikat 1, 4, 6, 8, 10 dhe grafikët A dhe B të Kontratës Financiare, siç përcaktohen në këtë Marrëveshje, për shtojca dhe ndryshime në Kontratën Financiare (shtojca dhe ndryshime);

- termat e përcaktuara në Kontratën Financiare do të kenë të njëjtin kuptim kur do të përdoren këtu, vetëm nëse përdoren shprehimisht ndryshe; nëse specifikohen ndryshe, në referencë me pikat, paragrafët, nënparagrafët do të hartohen në referencë me pikat, paragrafët, nënparagrafët e Kontratës Financiare, ku referencat të klauzolat do të hartohen si referenca të klauzolave të kësaj shtojce dhe ndryshimi.

Rrjedhimisht është rënë dakord si më poshtë vijon:

### I. Amendament dhe plotësues

Ky amendament dhe plotësues do të shtojë dhe plotësojë Kontratën Financiare, siç parashtrohet në klauzolat përkatëse të mëposhtme.

### II. Disbursimi

Artikulli 1.01 duhet të lexohet si më poshtë:

“Me anë të kësaj Kontrate, Banka përcakton në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi (që këtu referohet si “Kredi”) në një sasi të barasvlefshme me 19 000 000 euro (nëntëmbëdhjetë milionë), të përdoret ekskluzivisht për pjesën financuese të kostos së Projektit.”.

Termi “15 dhjetor 2006” i parashtruar në paragrafin e fundit të nenit 1.02 B duhet të lexohet “15 dhjetor 2007”.

Termi “15 prill 2007”, i parashtruar në paragrafin e fundit të nenit 1.05, duhet të lexohet “15 prill 2008”.

### III. Kushtet e disbursimit

Neni 1.04 A duhet të lexohet si më poshtë:

“A. Disbursimi i transhesë së parë sipas paragrafit 1.02 do të varet nga plotësimi i kushteve të mëposhtme sipas dëshirës së Bankës, pra përpara datës së kërkesës së parë:

a) Banka duhet të ketë marrë një opinion ligjor të kënaqshëm në gjuhën angleze mbi këtë kontratë nga një këshilltar ligjor ndaj Huamarrësit, kryesisht në formën e parashtruar në shtojcën II;

b) të gjitha lejet e nevojshme të kontrollit të shkëmbimit (nëse ka ndonjë) duhet të merren që t'i lejojnë Huamarrësit të marrë disbursimet e këtushme, të ripaguajë borxhin (siç parashtrohet në paragrafin 2.01) dhe të paguajë interesat dhe të gjitha shumat e tjera të detyruara këtu; dhe këto leje të zgjerojnë hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive për të cilat Huamarrësi i drejtohet Bankës të disbursojë kreditin;

c) Banka do të ketë marrë evidencën e kënaqshme të autoritetit të personave të autorizuar të firmosin dhe aprovojnë kërkesat dhe modelin autentik të këtij personi ose këtyre personave;

d) Banka duhet të ketë marrë evidencë të kënaqshme, me qëllim që një njësi zbatimi e Projektit e pajisur me stafin e duhur, që i është deleguar koordinimi i Projektit, është ngritur siç duhet brenda Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve sipas paragrafit 6.11;

e) Banka duhet të ketë marrë evidencë të kënaqshme nga Huamarrësi që kontrata e konsulencës sipas paragrafit 6.09 është tenderuar dhe kontraktuar, sipas kushteve të pranueshme të Bankës;

f) Banka duhet të ketë marrë evidencë të kënaqshme nga Huamarrësi që një kuadër institucional i përshtatshëm të jetë operacional përsa i përket njësisë së zbatimit të Projektit të sipërpërmendur dhe që detyrat e konsulentëve të supervizionit të merren sipas paragrafit 6.09;

g) Banka duhet të ketë marrë evidencë të kënaqshme nga Huamarrësi që e gjithë toka e nevojshme për punimet e ndërtimit të Projektit është e lirë dhe e disponueshme për kontraktuesit civilë dhe që të jenë marrë të gjitha lejet e nevojshme për punime të tilla ndërtimi të Projektit, duke përfshirë pa kufizim lejen e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit të Huamarrësit;

h) Banka duhet të ketë marrë nga Huamarrësi një kopje në gjuhën angleze të buxhetit të tij rrugor të aprovuar nga autoritetet përkatëse shqiptare për vitet 2003 dhe 2004, si edhe një parashikim të buxhetit rrugor për vitet 2005 deri në 2008, duke përfshirë shifra të detajuara për kostot e operimit, të mirëmbajtjes së tanishme, të mirëmbajtjes periodike dhe të rehabilitimit dhe investimit të detajuar nga donatorët.

Nëse një kërkesë për disbursim të transhesë së parë është bërë para marrjes nga Banka të evidencës së kënaqshme për të, që të jenë plotësuar këto kushte, një kërkesë e tillë duhet të gjykohet të jetë marrë nga Banka në datën që kushtet të jenë plotësuar.”.

#### IV. Shlyerja normale

Neni 4.01 duhet të lexohet si më poshtë:

“Huamarrësi duhet të shlyejë borxhin në përputhje me tabelën e amortizimit të parashtruar në tabelën B të kësaj Kontrate me 36 instalime gjysmëvjetore të kapitalit, e para e detyrueshme më 5 qershor 2008 dhe e fundit më 5 dhjetor 2025.”.

Tabela e re B e Kontratës Financiare është dhënë në shtojcë.

#### V. Plotësues për nenin 6: Sipërmarrje të veçanta

a) Huamarrësi merr përsipër të përmirësojë aksin rrugor në terren të vështirë të seksionit rrugor Gjirokastër-Tepelenë, duke pasur parasysh të evitohet tejkalimet e kostove;

b) Huamarrësi merr përsipër që nivele të qëndrueshme të shpenzimeve vjetore të mirëmbajtjes rrugore të jenë të disponueshme për Drejtorinë e tij të Përgjithshme të Rrugëve.

#### VI. Informacioni

Neni 8.01 duhet të lexohet si më poshtë:

“Huamarrësi duhet:

a) t'i dorëzojë Bankës në gjuhën angleze ose me përkthim në gjuhën angleze:

i) informacion në përmbajtje dhe në formë të specifikuar në planin A2 të kësaj Kontrate ose ndryshe siç është rënë dakord herë pas here nga palët e kësaj Kontrate dhe (b) çdo informacion i tillë ose dokument i mëtejshëm në lidhje me financimin, sigurimin, zbatimin, operimin dhe ndikimin në mjedis të ose për Projektin ashtu si Banka mundet në mënyrë të arsyeshme të kërkojë;

ii) një raport të përfundimit të Projektit 6 muaj pas përfundimit të Projektit;

iii) herë pas here, çdo dokument të mëtejshëm ose informacion lidhur me financimin, zbatimin dhe operimin e Projektit, ashtu si Banka e kërkon;

b) t'i paraqesë në kohë për aprovim Bankës ndonjë ndryshim material të programit të përgjithshëm, grafikut kohor, planit të financimit ose programit të shpenzimeve për Projektin, në varësi të marrëveshjeve të bëra nga Banka prioritare për firmosjen e kësaj Kontrate;

c) të informojë Bankën në çdo kohë për çdo situatë që kërkon pëlqimin e Bankës sipas paragrafit 6.08;

- d) t'i dorëzojë Bankës çdo vit:
- i) buxhetin rrugor, në gjuhën angleze, të miratuar nga autoritet përkatëse shqiptare për vitin aktual, ashtu si dhe për planifikimin e buxhetit rrugor për 4 vitet në vazhdim, duke përfshirë shifra të detajuara për kostot rrjedhëse, mirëmbajtjen aktuale, mirëmbajtjen periodike, rehabilitimin dhe investimet e caktuara nga donatori;
  - ii) një paraqitje të burimeve të marra për vitet e mëparshme, të përcaktuara midis tyre, si transfera nga Huamarrësi, huatë, dhurata, dhe çdo burim tjetër të ardhurash vjetore;
  - iii) herë pas here, çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me situatën e përgjithshme, ashtu si Banka e kërkon;
  - e) të sigurojë që çdo e dhënë të tregojë të gjitha operimet që kanë të bëjnë me financimin dhe zbatimin e Projektit;
  - f) të informojë Bankën për progresin e bërë ndaj vendosjes së fondit rrugor;
  - g) të informojë Bankën për çdo ndryshim institucional në organizimin e sektorit rrugor në Shqipëri.
- Skema e re A 2 e Kontratës Financiare është aneksuar.

#### VIII. Përshkrimi teknik

Termi “Përshkrimi teknik” i përcaktuar në përshkrimin e katërt të Kontratës Financiare do të zëvendësohet nga përshkrimi teknik i paraqitur në skemën e re A1 të këtij amendamenti dhe kësaj shtojce.

Plani i ri A1 i Kontratës Financiare është i aneksuar.

#### IX. Shtesë për pikën 10: Rastet kur njëra Palë prish Marrëveshjen

Të drejtat e Bankës, sipas pikës 10.01B(b) të Kontratës Financiare, do të jenë gjithashtu të aplikueshme edhe në rastin e një ndryshimi thelbësor të çdo materiali faktik të cituar në përshkrimin e këtij amendamenti dhe kësaj shtojce.

#### X. Dispozita të tjera

Të gjitha dispozitat e tjera të Kontratës Financiare do të mbeten të pandryshuara dhe të zbatueshme. Ky amendament dhe shtojcë, përshkrimet dhe anekset e tij (që jepen më poshtë) janë pjesë përbërëse e Kontratës Financiare.

Pjesët e mëposhtme përbëjnë anekset e këtij amendamenti dhe shtojce:

- Aneksi I: Grafiku A.1 i Kontratës Financiare (përshkrimi teknik);
- Aneksi II: Grafiku A.2 i Kontratës Financiare (informacioni);
- Aneksi III: Grafiku B i Kontratës Financiare (tabela e amortizimit).

#### XI. Detyrime dhe shpenzime

a) Taksat, doganat dhe tarifat

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, doganat dhe tarifat, si dhe të gjitha detyrimet e çfarëdolloj natyre, duke përfshirë vulat doganore dhe tarifat e regjistrimit, që burojnë si rrjedhojë e ekzekutimit ose e implementimit të këtij amendamenti dhe shtojce ose çdo lloj dokumenti që lidhet me të.

b) Detyrime të tjera

Huamarrësi do të mbështesë të gjitha kostot profesionale, bankare, të transfertave dhe të kursit të këmbimit, që do të buronin gjatë ekzekutimit ose zbatimit të këtij amendamenti dhe shtojce ose çdo lloj dokumenti që lidhet me të.

## XII. Ligji, juridiksioni dhe njoftimet

Pikat 11,12.01 dhe 12.02 të Kontratës Financiare kanë të njëjtin efekt në lidhje me këtë amendament dhe shtojcë.

Dëshmohet se palët pjesëmarrëse të këtij amendamenti dhe shtojcë e kanë hartuar këtë dokument në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe ia kanë deleguar të drejtën për të sigluar çdo faqe, respektivisht znj. Ylika Zaloshnja dhe z.Matteo Rivellini

Luksemburg, më 10 tetor 2005

Tiranë, më 11 tetor 2005

Firmosur nga, dhe në emër të Republikës  
së Shqipërisë  
Ministër i Financave  
Ridvan BODE

Firmosur nga, dhe në emër të Bankës  
Europiane të Investimeve  
Grammatiki Tsingou Papadopetrou,  
Drejtor  
Matteo Rivellini  
Këshilltar ligjor

### ANEKS I GRAFIKU A.1 I KONTRATËS FINANCIARE PËRSHKRIMI TEKNIK

#### 1. Vendndodhja

Projekti përfshin zotërimin e tokës, supervizionin dhe përmirësimin në shtratin e rrugës ekzistuese të 18.15 km rrugë mes Lushnjës dhe Fierit (seksioni A) dhe të 23.7 km shtrat rrugë mes Gjirokastrës dhe Tepelenës (seksioni B), që lidhen me Greqinë nëpërmjet një aksi kryesor veri-jug. Seksioni A do të përmirësohet me linja 2 x 2, sipas standardeve të autostradës dhe seksionit B me një gjerësi platforme respektivisht prej 9.50 m ose 10.50 m.

#### 2. Përshkrimi

Standardet e projektit janë përcaktuar si më poshtë:

	Seksioni A	Seksioni B	
	Lushnjë – Fier	Tepelenë – Gjirokastrë	
		Nëseksioni 1	Nëseksioni 2
		Gjirokastrë - Hormova	Hormova - Tepelenë
	km 0+000- 18+152	km 0+000- 11+000	km 11+000- 23+700
Shpejtësia:	100 km/h	80 km/h	60 km/h
Gjerësia e shtratin të rrugës:	2 x 2 x 3.75 m	2 x 3.75 m	2 x 3.50 m
Bankinat e kalueshme:	2 x 1.75 m	2 x 1.50 m	2 x 1.25 m
Bordura:	3.5 m (qendrore)	2 x 0.50 m	2 x 0.50 m
Gjerësia e platformës:	22.00 m	10.50 m	9.50 m

Struktura rrugore:

Seksioni A:

Standardi italian "Tipi B".

Struktura e rrugëve konsiston (nga sipërfaqja në fund) në 4 cm shtresë bituminoze, 6 cm shtresë binder, 15 cm konglomerati bituminoz, 40 cm shtresë bazë me material të thyer dhe nënshtresa të tjera sipas kushteve dhe terrenit.

Seksioni B:

Struktura rrugore konsiston (nga sipërfaqja në fund) në 4 cm shtresë bituminoze, 6 cm shtresë binder, 10 cm konglomerati bituminoz, një shtresë 30 cm shtresë bazë me material të thyer dhe një nënshtresë 30 cm zhavorr.

Seksionet A dhe B:

Punimet përfshijnë sistemin e drenazhimit (kanale, tubacione dhe tombino rrethore dhe katrore), mure mbajtëse, rehabilitimin e rrugëve hyrëse në afërsi të ndërprerjeve rrugore, zhvendosje të linjave furnizuese, pajisje rrugore horizontale dhe vertikale etj. Urat ekzistuese do të zëvendësohen ose riparohen dhe përshtaten sipas kërkesave të trafikut.

3. Shërbimet e konsulencës dhe menaxhimi i Projektit

Shërbimet e konsulencës ndërkombëtare janë parashikuar për dokumentet e tenderit dhe të projektit, supervizionin, kontrollin cilësor të punimeve dhe lëshimin e certifikatave mujore.

Punimet e përfshira në Projekt do të ndahen në 2 njësi të financuara paralelisht nga kooperacioni italian (seksioni A), së bashku me PHARE dhe BEI (seksioni B). Shërbimet e menaxhimit të Projektit janë supozuar të ndahen respektivisht në 2 pjesë dhe të financohen nga kooperacioni italian (seksioni A) dhe PHARE (seksioni B).

4. Kalendar

Seksioni A: Ndërtimi pritet nga tetori 2005 dhe shtatori 2007.

Seksioni B: Ndërtimi pritet nga shtatori 2005 dhe prill 2007.

## ANEKSI II

### GRAFIKU A.2 I KONTRATËS FINANCIARE (1/2)

#### INFORMACION MBI PROJEKTIN QË DUHET T'I DËRGOHET BANKËS DHE MËNYRA E TRANSMETIMIT TË TIJ

1. Shpërndarja e informacionit: caktimi i personit përgjegjës

Informacioni i mëposhtëm duhet t'i dërgohet Bankës nën përgjegjësinë e:

Institucioni	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve
Personi i kontaktit	Z. Artur Luca
Titulli	Drejtor / PMU-së
Funksioni i departamentit	Drejtor, Phare, CBC & Programet e transportit
Adresa	Zyrat e PMU së Transportit Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve Bul. "Dëshmorët e Kombit", hotel "Dajti", nr. 205 Tirana Albania
Tel:	+3554 234955 (Celular +355 6820 24281)
Faks;	I njëjtë me numrin e telefonit
E-mail:	

Personi i sipërpërmendur është përkohësisht personi përgjegjës i kontaktit. Huamarrësi duhet të njoftojë menjëherë BEI-n në rast të ndonjë ndryshimi.

## 2. Informacion mbi implementimin e Projektit

Huamarrësi duhet t'i japë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi progresin e Projektit gjatë implementimit të tij jo më vonë se afatet e përcaktuara më poshtë:

Dokumenti/informacioni	Afati	Frekuenca e Raportimi
<p>Raporti mbi progresin e Projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Azhurnim i shkurtër i aspekteve teknike, duke shpjeguar arsyet për ndryshime të rëndësishme nga projekti fillestar;</li> <li>- Azhurnim për afatet e përfundimit për secilin nga komponentët kryesorë të Projektit, duke shpjeguar arsyet për çdo vonesë të mundshme;</li> <li>- Azhurnim i kostos së Projektit, duke shpjeguar arsyet për çdo rritje të mundshme të kostos karshi kostos fillestare të dhënë në buxhet;</li> <li>- Një përshkrim për çdo çështje madhore që shkakton pasoja mbi mjedisin;</li> <li>- Azhurnim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së);</li> <li>- Azhurnim mbi kërkesat e Projektit dhe komente;</li> <li>- Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur ose çdo rrezik serioz që mund të influencojë mbi ecurinë e Projektit;</li> <li>- Çdo veprim ose proces ligjor që po ndodh në lidhje me Projektin.</li> </ul>	Jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të çdo periudhe raportimi	Çdo tre muaj

## ANEKSI II

### GRAFKU A.2 I KONTRATËS FINANCIARE (2/2)

## 3. Informacion për aspekte specifike

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm jo më vonë se afati i treguar më poshtë.

Dokumentet/informacioni	Afati
Draftprogram pesëvjeçar për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe program investimi për rrjetin kombëtar rrugor	15 janar, vjetor gjatë zbatimit të Projektit
Program përfundimtar pesëvjeçar për mirëmbajtje dhe program investimesh i aprovuar nga MTT	31 mars, vjetor gjatë zbatimit të Projektit

4. Informacion në fund të punimeve dhe vitit të parë të punimeve

Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm lidhur me fillimin dhe përfundimin e punimeve jo më vonë se afati i treguar më poshtë:

Dokumentet/informacioni	Data e dorëzimit në Bankë
<p>Raporti përfundimtar përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përshkrim të shkurtër të karakteristikave teknike të Projektit të përfunduar duke shpjeguar arsyet për çdo ndryshim të mundshëm;</li> <li>- data e përfundimit të përbërësve kryesorë të Projektit, duke shpjeguar arsyet e shtyrjeve të mundshme;</li> <li>- kostoja përfundimtare e Projektit, shpjegimi i arsyeve për rritje të kostove kundrejt kostos fillestare të buxhetit;</li> <li>- numri i punëve të krijuara nga Projekti: punët e reja të krijuara nga zbatimi dhe punimet e vazhdueshme;</li> <li>- përshkrim i ndonjë arsyeje madhore që ndikon në mjedis;</li> <li>- të dhënat e fundit për procedurat e prokurimeve;</li> <li>- të dhënat e fundit mbi kërkeat ose përdorimin e projekteve dhe komentet gjatë vitit të parë të punimeve;</li> <li>- çështje të veçanta që ndodhin ose ndonjë risk specifik që mund të ndikojë në punimet e Projektit;</li> <li>- veprime ligjore lidhur me Projektin.</li> </ul>	<p>Jo më vonë se 15 muaj pas përfundimit të punimeve (trafiku) të dhënat që mbulojnë vitin e parë të punimeve</p>

Gjuha e raporteve

ANEKSI III  
GRAFIKU B I KONTRATËS FINANCIARE  
TABELA E AMORTIZIMIT  
SHQIPËRI-PROJEKTI EUROPIAN RRUGOR

Data e vendosjes së amortizimit	Shumat për t'u ripaguar, të shprehura si përqindje të huasë	
1	05/06/2008	2.78%
2	05/12/2008	2.78%
3	05/06/2009	2.78%
4	05/12/2009	2.78%
5	05/06/2010	2.78%
6	05/12/2010	2.78%
7	05/06/2011	2.78%
8	05/12/2011	2.78%
9	05/06/2012	2.78%
10	05/12/2012	2.78%
11	05/06/2013	2.78%
12	05/12/2013	2.78%
13	05/06/2014	2.78%
14	05/12/2014	2.78%

15	05/06/2015	2.78%
16	05/12/2015	2.78%
17	05/06/2016	2.78%
18	05/12/2016	2.78%
19	05/06/2017	2.78%
20	05/12/2017	2.78%
21	05/06/2018	2.78%
22	05/12/2018	2.78%
23	05/06/2019	2.78%
24	05/12/2019	2.78%
25	05/06/2020	2.78%
26	05/12/2020	2.78%
27	05/06/2021	2.78%
28	05/12/2021	2.78%
29	05/06/2022	2.78%
30	05/12/2022	2.78%
31	05/06/2023	2.78%
32	05/12/2023	2.78%
33	05/06/2024	2.78%
34	05/12/2024	2.78%
35	05/06/2025	2.78%
36	05/12/2025	2.70%

## L I G J

**Nr. 9436, datë 20.10.2005**

### **PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË SHETIT TË VITIT 2004**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### V E N D O S I:

##### Neni 1

Miratohet Buxheti faktik i Shtetit i vitit 2004 dhe i burimeve të tij të financimit, si më poshtë:

1. Buxheti i Shtetit		
- Të ardhurat gjithsej	151 094	milionë lekë;
- Shpenzimet gjithsej	188 180	milionë lekë;
2. Buxheti i sigurimeve shoqërore		
- Të ardhurat	44 073	milionë lekë;
- Shpenzimet	44 490	milionë lekë;

3. Buxheti i sigurimeve shëndetësore		
- Të ardhurat	5 178	milionë lekë;
- Shpenzimet	5 760	milionë lekë;
4. Deficiti buxhetor	38 083	milionë lekë;
5. Financimi i deficitit buxhetor	38 083	milionë lekë;
I brendshëm	30 870	milionë lekë;
A. Me instrumente financiare		
(kredimarrje e brendshme neto)	14 465	milionë lekë;
- Kredi nga Banka e Shqipërisë	0	milionë lekë;
- Bono thesari	5 922	milionë lekë;
- Obligacione qeveritare 2-vjeçare	8 543	milionë lekë;
B. Të ardhura nga privatizimi	14 356	milionë lekë;
C. Të tjera	2 049	milionë lekë;
- Ndryshimi i gjendjes së arkës	982	milionë lekë;
- Të tjera	1 067	milionë lekë;
Financim i jashtëm neto	7 213	milionë lekë;
Nga i cili:		
- Mbështetje buxhetore	1 993	milionë lekë;

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4692, datë 8.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:  
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; 267 468  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al) ose [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR  
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA
2. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE
3. REGJISTRI I TESTAMENTEVE
4. INDEKSI ALFABETIK

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

- |   |      |
|---|------|
| 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....   | 1500 |
| 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) .....                                  | 600  |
| 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005)..... | 1500 |
| 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....  | 1500 |
|   |      |
| 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ....     | 1500 |
| 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....         | 2000 |

**BOTIME TË REJA**

1. KODI DOGANOR
2. KODI DETAR

Doli nga shtypi më 14.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë